



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Nr. 6538 Prot

Vau Dejes, me 18.11.2022

Lënda: Dërgim Projekt Vendimi

Drejtuar:

**KËSHILLIT TË BASHKISË
VAU DEJËS**

Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006

Në zbatim të detyrimeve që dalin nga Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, të ligjit nr 152/2015 dt 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", bashkëlidhur po ju dërgojmë Projekt Vendimin nr. datë / /2022 "Për shpërblimin e stafit të shërbimit vendor të MZSH-së në bashkinë Vau Dejes".

Bashkëlidhur projekt vendimit jepen:

1. Memo drejtuar Kryetarit të Bashkisë Nr. 6538 Prot, Datë 18/11 /2022.
2. Relacion hartuar nga Sektori i Mbrojtjes Nga Zjarri dhe Shpëtimi Nr. 6538/1 Prot, Datë 18/11 /2022.
3. Lista e stafit të propozuar për shpërblim.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

Konceptoi: *Samuel Water*

Miratoi: *Leonard Yodac*

**KRYETARI
MARK BABANI**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

**ZV/ KRYTARI
KRISTIAN SHKRELI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Nr. ___ Prot

Vau Dejes, me 17.11.2022

PROJEKT VENDIM

Nr. 01, Datë 17/11/2022

“Për shpërblimin e stafit të shërbimit vendor të MZSH-së në bashkinë Vau Dejes”

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Nenet 4,6,7,14,15,17,22,33 të ligjit nr. 152/2015 dt 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Neni 7,12,28 të Ligjit 10142, date 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Urdhrin nr. 3227/1 Prot., datë 19.09.2022 I Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH, Ministria e Brendshme, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau- Dejes të:

VENDOSI

1. Miratimin e shpërblimit të stafit vendor në masën e 1 (një) page të stafit të shërbimit vendor të MZSH-së në bashkinë Vau Dejes.
2. Vlera e pagave referuese të bëhet në përputhje me ligjin nr. 152/2015 Dt 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Konceptoi: *Samuel Koster*

Miratoi: *Leonard Kodani*

KRYETARI
MARK BABANI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/ KRYTARI
KRISTIAN SHKRELI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Nr 653/Prot

Vau Dejes, me 18 . 11 .2022

RELACION

Për mundësinë e shpërblimit të stafit të shërbimit vendor të MZSH-së në bashkinë Vau Dejes.

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në legjislacionin që normon veprimatrinë e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (ligji nr.152/2015 “Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin”), si dhe të përcaktimeve të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” në cilësinë e drejtuesit të strukturës së MZSH-së në bashki, kërkoj të që brenda mundësive të buxhetit të bashkisë të vlerësoni dhe të adresoni pranë këshillit bashkiak mundësinë shpërblimin e stafit të shërbimit vendor të MZSH-së me një rrogë mujore.

Situata e sapo kaluar lidhur me kompleksitetin e zjarreve në territorin e bashkisë sonë, si dhe puna e lavdërueshme e stafit të strukturës zjarrfikëse, në drejtin të ndërhyrjeve operacionale dhe minimizimit të dëmeve në pasuritë publike apo private, në kuadër të përmirësimit të nivelit të performancës të shërbimit të MZSH-së në këtë bashki, me qëllim rritjen dhe garantimin e sigurisë publike nga rreziku i zjarrit në territorin e bashkisë, kërkohet vëmendja Juaj në cilësinë e autoritetit të kryetarit të bashkisë, që të ushtrohni në mënyrë proaktive kompetencat të ngarkuara nga legjislacioni sektorial në harmoni dhe me ligjin nr.139.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (neni 29/2).

Përgjegjësitë e autoritetit të kryetarit të bashkisë dhe Këshillit Bashkiak në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, krahas detyrimeve specifike të përcaktuara në nenin 9 të ligjit nr.152/2015, kanë të bëjnë edhe me përmirësimin e kushteve të punës për këtë strukturë me status të vecantë.

Germën “a” të nenit 31 të ligjit nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” përcakton: “1. Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, për shkak të përgjegjësisë dhe

rrezikshmërisë së lartë në detyrë, në raport me strukturat e tjera të administratës shtetërore, gëzon trajtim të veçantë, të përcaktuar në këtë ligj....”.

Aktualisht shërbimi i MZSH-së trajtohet me paga sipas përcaktimit të VKM-në nr.350, datë 19.04.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Referuar nenit 5 të ligjit nr.10405, datë 24.03.2011, i ndryshuar, (kompetencat e këshillave të qeverisjes vendore) kryetari i bashkisë ka tagrin ligjor që ti propozojë këshillit bashkiak ndër të tjera shpërblimin e stafit të shërbimit vendor të MZSH-së, situatë e parashikuar nga neni 54 (Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak) të ligjit nr.139/2015.

Neni 5 Kompetencat e këshillave të qeverisjes vendore i ligjit nr.10405 përcakton:

Këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, këshilli komunal, sipas përkatësisë, miratojnë:

a) pagën për çdo funksion të zgjedhur, të emëruar, për nëpunësit dhe punonjësit e tjerë, brenda kufijve të pagave për çdo grup të njësive të qeverisjes vendore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave;

b) njehsimin në pagë, në përputhje me klasifikimin e funksioneve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, për çdo funksion të ri që vendos të krijojë;

c) shpërblimin mujor të këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave, në masën deri në 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të këshillit të qarkut, të kryetarit të bashkisë dhe të kryetarit të komunës;

c) shpërblime të personave, nga burimet e veta financiare, të cilët caktohen në komitete, borde, këshilla, komisione, e të tjera të kësaj natyre, që ngrihen me vendim të këshillit përkatës;

d) pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë së tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të rasteve kur me ligj të veçantë është parashikuar ndryshe.

Shpërblimin e stafit të shërbimit vendor të MZSH-së, qoftë edhe me vlerat e një page, do të ndikojë sadopak në përmirësimin evlerave monetare që marrin punonjësit e shërbimit zjarrfikës sipas VKM-së nr.350, datë 19.04.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, situatë e cila diktohet edhe nga raporti me strukturat e tjera të administratës shtetërore, ku struktura e shërbimit zjarrfikës trajtohen më pak se çdo strukturë tjetër, çka nuk reflekton aspak detyrimin ligjor të përcaktuar germën “a” të nenit 31 të ligjit nr.152/2015, ku është sanksionuar se, punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, për shkak të përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së lartë në detyrë, në raport me strukturat e tjera të administratës shtetërore, gëzon trajtim të veçantë, të përcaktuar në ligj.

Duke Ju falenderuar për vëmëndjen Tuaj.

Leonard Doda



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

SEKTORI I MZSH

Nr 638 prot.

Vau Dejës, më 18 . 11 .2022

MEMO

Drejtuar: Z. MARK BABANI

KRYETARI I BASHKISË VAU DEJËS

Nga: Z. Leonard Dodani

Shefi i Sektorit të MZSH-së (I komanduar)

Objekti: Për mundësinë e shpërblimit të stafit të shërbimit vendor të MZSH-së në bashkinë Vau Dejes.

I nderuar Z. Kryetar,

Bazuar në legjislacionin që normon veprimatrinë e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (ligji nr.152/2015 “Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin”), si dhe të përcaktimeve të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” në cilësinë e drejtuesit të strukturës së MZSH-së në bashki, kërkoj të që brenda mundësive të buxhetit të bashkisë të vlerësoni dhe të adresoni pranë këshillit bashkiak mundësinë shpërblimin e stafit të shërbimit vendor të MZSH-së me një rrogë mujore.

Situata e sapo kaluar lidhur me kompleksitetin e zjarreve në territorin e bashkisë sonë, si dhe puna e lavdërueshme e stafit të strukturës zjarrfikëse, në drejtin të ndërhyrjeve operacionale dhe minimizimit të dëmeve në pasuritë publike apo private, në kuadër të përmirësimit të nivelit të performancës të shërbimit të MZSH-së në këtë bashki, me qëllim rritjen dhe garantimin e sigurisë publike nga rreziku i zjarrit në territorin e bashkisë, kërkohet vëmendja Juaj në cilësinë e autoritetit të kryetarit të bashkisë, që të ushtrohni në mënyrë proaktive kompetencat të ngarkuara nga

legjislacioni sektorial në harmoni dhe me ligjin nr.139.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (neni 29/2).

Përgjegjësitë e autoritetit të kryetarit të bashkisë në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, krahas detyrimeve specifike të përcaktuara në nenin 9 të ligjit nr.152/2015, kanë të bëjnë edhe me përmirësimin e kushteve të punës për këtë strukturë me status të veçantë.

Germën “a” të nenit 31 të ligjit nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” përcakton: “1. *Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, për shkak të përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së lartë në detyrë, në raport me strukturat e tjera të administratës shtetërore, gëzon trajtim të veçantë, të përcaktuar në këtë ligj....*”.

Aktualisht shërbimi i MZSH-së trajtohet me paga sipas përcaktimit të VKM-në nr.350, datë 19.04.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Referuar nenit 5 të ligjit nr.10405, datë 24.03.2011, i ndryshuar, (kompetencat e këshillave të qeverisjes vendore) kryetari i bashkisë ka tagrin ligjor që ti propozojë këshillit bashkiak ndër të tjera shpërblimin e stafit të shërbimit vendor të MZSH-së, situatë e parashikuar nga neni 54 (Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak) të ligjit nr.139/2015.

Neni 5 Kompetencat e këshillave të qeverisjes vendore i ligjit nr.10405 përcakton:

Këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, këshilli komunal, sipas përkatësisë, miratojnë:

a) pagën për çdo funksion të zgjedhur, të emëruar, për nëpunësit dhe punonjësit e tjerë, brenda kufijve të pagave për çdo grup të njësisve të qeverisjes vendore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave;

b) njehsimin në pagë, në përputhje me klasifikimin e funksioneve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, për çdo funksion të ri që vendos të krijojë;

c) shpërblimin mujor të këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave, në masën deri në 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të këshillit të qarkut, të kryetarit të bashkisë dhe të kryetarit të komunës;

c) shpërblime të personave, nga burimet e veta financiare, të cilët caktohen në komitete, borde, këshilla, komisione, e të tjera të kësaj natyre, që ngrihen me vendim të këshillit përkatës;

d) pagat e punonjësve të njësisve ekonomike dhe të institucioneve të varësisë së tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të rasteve kur me ligj të veçantë është parashikuar ndryshe.

Shpërblimin e stafit të shërbimit vendor të MZSH-së, qoftë edhe me vlerat e një page, do të ndikojë sadopak në përmirësimin evlerave monetare që marrin punonjësit e shërbimit zjarrfikës sipas

VKM-së nr.350, datë 19.04.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, situatë e cila diktohet edhe nga raporti me strukturat e tjera të administratës shtetërore, ku struktura e shërbimit zjarrfikës trajtohen më pak se çdo strukturë tjetër, çka nuk reflekton aspak detyrimin ligjor të përcaktuar germën “a” të nenit 31 të ligjit nr.152/2015, ku është sanksionuar se, punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, për shkak të përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së lartë në detyrë, në raport me strukturat e tjera të administratës shtetërore, gëzon trajtim të veçantë, të përcaktuar në ligj.

Duke Ju falenderuar për vëmëndjen Tuaj.

Shefi i Sektorit të MZSH-së (I komanduar)

Leonard DODANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Nr. __. Prot.

Vau Dejës , më __.11.2022

Drejtuar: Z. MARK BISHA
KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË VAU DEJËS

Nga: Z. Leonard Dodani
Shefi i Sektorit të MZSH-së (I komanduar)

Lënda: Dërgojmë listën e stafit të shërbimit vendor të MZSH-së në bashkinë Vau Dejes.

I nderuar Z. Kryetar i Këshillit Bashkiak dhe anëtarë të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, më poshtë gjeni bashkangjitur listën e punonjësve stafit të shërbimit vendor të MZSH-së të cilët kemi propozuar për shpërblim.

Nr.	Emër	Mbiemër	Pozicioni
1.	Leonard	<u>Dodani</u>	<u>Shef sektori</u>
2.	Gjovalin	<u>Zefi</u>	<u>Inspektor</u>
3.	Aldo	Hila	Zjarrfikës
4.	Fatjon	Mhilli	Asistent
5.	Mikel	Lazri	Asistent
6.	Gjovani	Kola	Asistent
7.	Glen	Rrotani	Asistent
8.	Anton	Palushani	Asistent
9.	Pashuk	Filipi	Asistent

10.	Edmond	Palushaj	Asistent
11.	Dedë	Gjergji	Asistent
12.	Klodian	Gjoni	Zjarrfikës
13.	Markos	Huba	Asistent
14.	Dedë	Perzefi	Asistent
15.	Sulejman	Babaj	Asistent
16.	Qazim	Dashi	Zjarrfikës
17.	Zef	Hilaj	Asistent
18.	Luendro	Guri	Asistent
19.	Nikola	Kulli	Asistent

Miratoj:
Leonard Dodani

